

LISTA KONTROLLUESE E KRITEREVE PËR SUNDIMIN E LIGJIT



KOMISIONI EVROPIAN PËR DEMOKRACI PËRMES LIGJIT (KOMISIONI I VENEDIKUT)

LISTA E KONTROLLIT TË KRITEREVE PËR SUNDIMIN E LIGJIT

Miratuar nga Komisioni i Venedikut
në seancën e 106-të plenare
(Venedik, 11-12 mars 2016)

bazuar në komentet e
Z. Sergio BARTOLE
(anëtar zëvendësues, Itali)
Znj. Veronika BILKOVA
(anëtare, Republika Çeke)
Znj. Sarah CLEVELAND
(anëtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës)
Z. Paul CRAIG
(anëtar zëvendësues, Mbretëria e Bashkuar)
Z. Jan HELGESEN
(anëtar, Norvegji)
Z. Wolfgang HOFFMANN-RIEM
(anëtar, Gjermani)
Z. Kaarlo TUORI (anëtar, Finlandë)
Z. Pieter van DIJK
(ish-anëtar, Holandë)
Sir Jeffrey JOWELL
(ish-anëtar, Mbretëria e Bashkuar)

Këshilli i Evropës

Të gjitha kërkesat
lidhur me riprodhimin ose përkthimin
e tërësishëm ose të pjesshëm të
këtij dokumenti duhet t'i drejtohen

Drejtorisë së
Komunikimit (F-67075 Stras-
bourg Cedex ose publicing@
coe.int). E gjithë korrespon-
denca tjetër në lidhje me këtë
dokument duhet t'i drejtohet
Komisionit të Venedikut, DG-I,
Këshillit të Evropës, F-67075
Strasbourg Cedex ose
venice@coe.int.

Kopertina: Departamenti i Prodhimit
të Dokumenteve dhe Publikimi
meve (DPDP),

Këshilli i Evropës

Struktura: Kuorum Italia
© Këshilli i Evropës, maj
2016

*Përkthimi dhe shtypja e këtij
dokumenti është mbështetur nga
Misioni i OSBE-së në Kosovë.*

Përmbajtja

I. HYRJE	7
A. Qëllimi dhe fushëveprimi	8
B. Sundimi i ligjit në mjedis të favorshëm	14
II. KRITERET	17
A. Ligjshmëria	17
1. Epërsia e ligjit	17
2. Pajtueshmëria me ligjin	18
3. Marrëdhënia ndërmjet së drejtës ndërkombëtare dhe së drejtës vendore	19
4. Kompetencat ligjbërëse të ekzekutivit	20
5. Procedurat e ligjbërjes	21
6. Përfshirjet në situata emergjente	22
7. Detyrimi për zbatim të ligjit	23
8. Akterët privatë të ngarkuar me detyra publike	24
B. Siguria Juridike	25
1. Qasja në legjislacion	25
2. Qasja në vendime gjyqësore	25
3. Parashikueshmëria e ligjeve	25
4. Stabiliteti dhe konsistenca e ligjit	26
5. Pritshmëritë legjitime	26
6. Mosaplikimi prapaveprues i ligjeve	27
7. Parimi nullum crimen sine lege dhe nulla poena sine lege	27
8. Res judicata	28
C. Parandalimi dhe shpërdorimi i pushtetit	29

D. Barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi	30
1. Parimi	30
2. Mosdiskriminimi	30
3. Barazia në ligj	31
4. Barazia para ligjit	32
E. Qasja në drejtësi	33
1. Pavarësia dhe paanshmëria	33
a. Pavarësia e gjyqësorit	33
b. Pavarësia e gjyqtarëve individualë	37
c. Paanshmëria e gjyqësorit	38
d. Shërbimi i prokurorisë: autonomia dhe kontrolli	38
e. Pavarësia dhe paanshmëria e Odës	40
2. Gjykimi i drejtë	42
a. Qasja në gjykata	42
b. Prezumimi i pafajësisë	44
c. Aspekte të tjera të së drejtës për gjykim të drejtë	45
d. Efektiviteti i vendimeve gjyqësore	46
3. Drejtësia kushtetuese (nëse është e zbatueshme)	46
F. Shembuj të sfidave të veçanta ndaj sundimit të ligjit	49
1. Korrupsioni dhe konflikti i interesit	49
a. Masat parandaluese	49
b. Masat në të drejtën penale	50
c. Respektimi dhe zbatimi efektiv i masave parandaluese dhe represive ⁵¹	51
2. Mbledhja e të dhënave dhe mbikëqyrja	52
a. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale	52
b. Vëzhgimi i shënjestruar	55
c. Vëzhgimi strategjik	55
d. Vëzhgimi me video	56
III. STANDARDET E PËRZGJEDHURA	57
III.a. Standardet e përgjithshme të sundimit të ligjit	57
1. Ligji i fortë	57
2. Ligji i butë	58
a. Këshilli i Evropës	58
b. Bashkimi Evropian	58
c. Organizata të tjera ndërkombëtare	58
d. Treguesit e sundimit të ligjit	59

III.b. Standardet në lidhje me kriteret	59
A. Ligjshmëria	59
1. Ligji i fortë	59
2. Ligji i butë	60
B. Siguria juridike	61
1. Ligji i fortë	61
2. Ligji i butë	61
C. Parandalimi i shpërdorimit të pushtetit	61
1. Ligji i fortë	61
2. Ligji i butë	62
D. Barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi	62
1. Ligji i fortë	62
a. Këshilli i Evropës	62
b. Bashkimi Evropian	62
c. Organizata të tjera ndërkombëtare	63
2. Ligji i butë	64
E. Qasja në drejtësi	65
1. Ligji i fortë	65
2. Ligji i butë	66
a. Këshilli i Evropës	66
b. Bashkimi Evropian	67
c. Kombet e Bashkuara	68
d. Komonuelthi i Kombeve	69
e. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë	70
f. Organizata të tjera ndërkombëtare	70
g. Tjera	70
F. Shembuj të sfidave të veçanta për Sundimin e Ligjit	71
1. Ligji i fortë	71
a. Korrupsioni	71
b. Mbledhja e të dhënave dhe mbikëqyrja	71
2. Ligji i butë	71
a. Korrupsioni	71
b. Mbledhja e të dhënave dhe mbikëqyrja	72

I. Hyrje

1. Në seancën e 86-të plenare (mars 2011), Komisioni i Venedikut miratoi Raportin për sundimin e ligjit (CDL-AD(2011)003rev). Ky raport identifikonte tiparet e përbashkëta të sundimit të ligjit, gjegjësisht "*Rechtsstaat*" dhe "*Etat de droit*". Raporti në fjalë kishte të bashkëlidhur versionin fillestar të një liste kontrolli për vlerësim të gjendjes së sundimit të ligjit në shtete të caktuara.

2. Më 2 mars 2012, nën patronatin e Kryesimit nga MB të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, dhe në bashkëpunim me Zyrën e Mbretërisë së Bashkuar për Punë të Jashtme dhe Komonuelth dhe Qendrën Bingham për Sundim të Ligjit, Komisioni i Venedikut organizoi konferencën me temë "Sundimi i ligjit si koncept praktik". Përfundimet e punimeve të kësaj konference nënvizonin se Komisioni i Venedikut do të përpilonte listën e kontrollit ku do të përfshiheshin mes tjerash disa nga sugjerimet e dhëna në konferencë.

3. Grupi i ekspertëve në përbërje të z. Bartole, znj. Bilkova, znj. Cleveland, z. Craig, z. Helgesen, z. Hoffmann-Riem, z. Tuori, z. van Dijk dhe Sir Jeffrey Jowell përgatitën versionin e hollësishëm të listës së kontrollit të paraqitur këtu.

4. Komisioni i Venedikut dëshiron të vë në dukje kontributin e Qendrës Bingham për Sundimin e Ligjit, veçanërisht për sa i përket përpilimit të standardeve të përzgjedhura në pjesën III. Gjithashtu, Komisioni dëshiron t'i falënderojë sekretariatet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE), Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Mos-durimit (KERM), Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), si dhe të OSBE/ODIHR dhe të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (ADTH) për bashkëpunimin e tyre.

5. Pjesa hyrëse (I) e sqaron fillimisht qëllimin dhe fushëveprimin e raportit, pasuar nga shtjellimi i marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet sundimit të ligjit nga njëra anë dhe demokracisë dhe të drejtave të njeriut nga ana tjetër (“Sundimi i ligjit në një mjedis të favorshëm”).

6. Pjesa e dytë (II, kriteret) përbën boshtin e listës së kontrollit dhe shtjellon aspektet e ndryshme të sundimit të ligjit të identifikuar në raportin e vitit 2011: ligjshmëria, siguria juridike, parandalimi i shpërdorimit të pushtetit, barazia para ligjit, si dhe mosdiskriminimi e qasja në drejtësi, kurse kapitulli i fundit jep dy shembuj të sfidave të veçanta ndaj sundimit të ligjit (korrupsioni dhe konflikti i interesit, dhe mbledhja e të dhënave dhe vëzhgimi).

7. Pjesa e tretë (III, standardet e përzgjedhura) renditë instrumentet më të rëndësishme të legjislacionit të detyrueshëm (ligjet e forta) dhe jo të detyrueshëm (ligjet e buta) që trajtojnë çështjen e sundimit të ligjit.

8. Kjo listë kontrolli ka qenë objekt i diskutimeve të Nënkomitetit për Sundim të Ligjit më 17 dhjetor 2015 dhe më 10 mars 2016, dhe është miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën e tij të 106-të plenare (Venedik, 11-12 mars 2016).

A. Qëllimi dhe fushëveprimi

9. Sundimi i ligjit është koncept me vlefshmëri universale. “Nevoja për respektimin dhe zbatimin universal të sundimit të ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar” është pohuar nga të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara në Dokumentin e rezultateve të Samitit Botëror të vitit 2005 (§ 134). Siç thuhet në Preambulën dhe në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE), sundimi i ligjit është një nga vlerat themelore të përbashkëta të Bashkimit Evropian (BE) dhe të shteteve të tij anëtare.¹ Në Kornizën e re për forcimin e sundimit të ligjit të vitit 2014, Komisioni Evropian rikujton se “parimi i sundimit të ligjit është kthyer gradualisht në një model organizativ mbizotërues në të drejtën kushtetuese moderne dhe në organizatat ndërkombëtare /.../ për të rregulluar ushtrimin e kompetencave publike” (f. 3-4). Një numër në rritje i shteteve i referohen sundimit të ligjit në kushtetutat e tyre kombëtare.²

10. Sundimi i ligjit është shpallur parim themelor në nivel global nga Kombet e Bashkuara, për shembull në Treguesit e sundimit të ligjit, si dhe në nivel rajonal nga Organizata e Shteteve Amerikane, gjegjësisht në Kartën Demokratike Ndëramerikane, dhe Bashkimi Afrikan, në veçanti në aktin e tij themelues. Ai përmendet gjithashtu në disa dokumente të Ligës Arabe.

1. Shih, për shembull, FRA (Fundamental Rights Agency) (2016), *Fundamental rights: challenges and achievements in 2015 – FRA Annual report 2013*, Luksemburg, Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian (Zyra e Publikimeve), Kapitulli 7 (e ardhshme).

2. Cf. CDL-AD(2011)003rev, § 30ff

11. Sundimi i ligjit përmendet në Preambulën e Statutit të Këshillit të Evropës si një nga tre “parimet që përbëjnë bazën e gjithë demokracisë së vërtetë”, krahas lirisë individuale dhe lirisë politike. Neni 3 i Statutit e bën respektimin e parimit të sundimit të ligjit parakusht për anëtarësimin e shteteve të reja në Këshill të Evropës. Pra, së bashku me demokracinë dhe të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit është një nga tre parimet themelore të Këshillit të Evropës që ndërthuren dhe mbivendosen pjesërisht me njëra-tjetrën. Lidhja e ngushtë ndërmjet sundimit të ligjit dhe një shoqërie demokratike është nënvizuar në formulime të ndryshme nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut: “një shoqëri demokratike e përkushtuar ndaj sundimit të ligjit”, “shoqëri demokratike e bazuar në sundimin e ligjit” dhe, në mënyrë më sistematike, “sundimi i ligjit në një shoqëri demokratike”. Realizimi i këtyre tre parimeve, respektimit të të drejtave të njeriut, demokracisë pluraliste dhe sundimit të ligjit, konsiderohet se përbën synim të veçantë dhe kryesor të Këshillit të Evropës.

12. Sundimi i ligjit përmendet sistematikisht në dokumentet kryesore të politikave të Këshillit të Evropës dhe në konventa e rekomandime të shumta. Në veçanti, sundimi i ligjit përmendet si element i trashëgimisë së përbashkët në Preambulën e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), si parim themeltar i demokracive evropiane në Rezolutën Res(2002)12 që themelon Komisionin Evropian për Efikasitet të Drejtësisë (KEED), dhe si synim me prioritet në Statutin e Komisionit të Venedikut. Mirëpo, Këshilli i Evropës nuk e ka përkufizuar sundimin e ligjit në asnjë tekst dhe as nuk ka krijuar ndonjë mekanizëm të veçantë monitorues për çështje të sundimit të ligjit.

13. Këshilli i Evropës ka vepruar megjithatë në disa aspekte me synimin për të promovuar dhe forcuar sundimin e ligjit nëpërmjet disa prej organeve të tij, veçanërisht Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë (KEED), Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve të Evropës (KKGJE), Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), Komitetit Monitorues të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Komisionerit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit të Venedikut.

14. Në raportin e tij të vitit 2011 për sundimin e ligjit,³ Komisioni i Venedikut ka shqyrtuar konceptin e sundimit të ligjit në vazhden e Rezolutës 1594(2007) të Asamblesë Parlamentare, e cila tërhoqi vëmendjen për nevojën për të siguruar interpretim të saktë të termave “sundim i ligjit”, “Rechtsstaat” dhe “Etat de droit” ose “prééminence du droit”, që ndërthen parimet e ligjshmërisë dhe të procesit të rregullt ligjor.

15. Komisioni i Venedikut ka analizuar përkufizimet e propozuara nga autorë të ndryshëm nga sisteme juridike, organizata shtetërore dhe kultura të ndryshme juridike. Komisioni ka vlerësuar se nocioni i sundimit të ligjit

3. CDL-AD(2011)003rev

kërkon sistem të sigurisë dhe parashikueshmërisë juridike në të cilin secili ka të drejtë të trajtohet nga të gjithë vendimmarrësit në mënyrë dinjitoze, të barabartë e racionale dhe në përputhje me ligjet, si dhe të ketë mundësinë për t'i kundërshtuar vendimet para gjykatave të pavarura dhe të paanshme në një procedurë të drejtë. Komisioni ka paralajmëruar kundër rreziqeve të një koncepti thjesht formalist të sundimit të ligjit, sipas të cilit do të nevojitej thjesht që çdo veprim i një zyrtari publik të autorizohet me ligj. "Sundimi me ligj" apo "Isundimi me ligje", qoftë edhe "ligji sipas rregullave", janë interpretime të shtrembëruara të sundimit të ligjit.⁴

16. Komisioni ka theksuar gjithashtu se të drejtat individuale të njeriut preken jo vetëm nga veprimet e autoriteteve shtetërore, por edhe nga veprimet e akterëve hibridë (publiko-privatë) dhe të subjekteve private që ushtrojnë detyra që kanë qenë më parë kompetencë e autoriteteve shtetërore ose që përfshijnë vendime të njëanshme që prekin një numër të madh njerëzish, si dhe ato të organizatave ndërkombëtare dhe mbikombëtare. Komisioni ka rekomanduar që parimet e sundimit të ligjit të zbatohen edhe në këto fusha.

17. Sundimi i ligjit duhet të zbatohet në të gjitha nivelet e pushtetit publik. Parimet e sundimit të ligjit zbatohen përshtatshmërisht edhe në marrëdhëniet e së drejtës private. Përkufizimi i mëposhtëm, i dhënë nga Tom Bingham, i merr parasysh më së miri elementët thelbësorë të sundimit të ligjit: "çdo person dhe autoritet shtetëror, qoftë publik apo privat, është i detyruar t'u bindet dhe të ketë të drejtën të përfitojë nga legjislacioni i miratuar publikisht që hyn në fuqi (në përgjithësi) në të ardhmen dhe administrohet publikisht nga gjykatat".⁵

18. Në raportin e tij, Komisioni ka arritur në përfundimin se, përkundër dallimeve në mendime, ka pajtueshmëri për sa u përket elementëve thelbësorë të sundimit të ligjit, si dhe për ata të "Rechtsstaat" dhe të "Etat de droit", që nuk janë vetëm formale, por edhe substanciale ose material (materieller Rechtsstaatsbegriff). Këta elementë thelbësorë janë: (1) ligjshmëria, përfshirë procesin transparent, të përgjegjshëm dhe demokratik të nxjerrjes së legjislacionit; (2) siguria juridike; (3) ndalimi i arbitraritetit; (4) qasja në drejtësi para gjykatave të pavarura dhe të paanshme, përfshirë shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative; (5) respektimi i të drejtave të njeriut; dhe (6) mosdiskriminimi dhe barazia para ligjit.

4. Shih Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Propozimi për rezolutë i paraqitur nga z. Holovaty dhe të tjerë, Parimi i sundimit të ligjit, Doc. 10180, § 10. Në këtë kontekst, shih gjithashtu dokumentin e Kopenhagës të KSBE-së, paragrafin 2: "[Shtetet pjesëmarrëse] konsiderojnë se nocion i sundimit të ligjit nuk nënkupton thjesht ligjshmëri formale që siguron rregullsi dhe njëtrajtshmëri në sendërtimin dhe zbatimin e rendit demokratik, por drejtësi të bazuar në njohjen dhe pranimin e plotë të vlerës supreme të personalitetit të njeriut dhe të garantuar nga institucionet që sigurojnë kornizën për shprehjen e tij sa më të plotë."

5. Tom Bingham, *The Rule of Law* (2010)

19. Meqë raporti i vitit 2011 kishte për qëllim të lehtësonte kuptimin dhe interpretimin e saktë dhe të njëtrajtshëm të konceptit të sundimit të ligjit dhe, kështu, synonte lehtësimin e zbatimit praktik të parimeve të sundimit të ligjit, atij i ishte bashkëngjitur një “listë kontrolli e kriterëve për vlerësimin e gjendjes së sundimit të ligjit në një shtet” që i rendiste gjashtë elementët e sipërpërmendur, të kategorizuar sipas disa nënparametrave.

20. Në vitin 2012, në një konferencë që Komisioni i Venedikut e kishte organizuar në Londër nën patronatin e Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar dhe në bashkëpunim me Qendrën Bingham për Sundimin e Ligjit, Komisioni nisi projektin për zhvillimin e mëtejshëm të listës së kontrollit si një qasje funksionalisht inovative për vlerësimin e gjendjes së sundimit të ligjit në një shtet të caktuar.

21. Në vitin 2013, Këshilli i Bashkimit Evropian filloi të realizojë Dialogun e të ri për sundimin e ligjit me shtetet anëtare, që zhvillohet çdo vit. Ai nënvizoi se “respektimi i shtetit të së drejtës është parakusht për mbrojtjen e të drejtave themelore” dhe i bëri thirrje Komisionit “të çojë përpara debatin, në përputhje me traktatet, mbi nevojën dhe formën e mundshme të një metode sistematike, të bazuar në bashkëpunim, për t’i trajtuar këto çështje”.⁶ Në vitin 2014, Komisioni Evropian krijoi një mekanizëm për adresimin e problemeve sistematike që prekin sundimin e ligjit në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE). Kjo “kornizë e re e BE-së për forcimin e sundimit të ligjit” krijon një instrument paralajmërimi të hershëm bazuar në “indikacionet e marra nga burimet e disponueshme dhe institucionet e njohura, përfshirë Këshillin e Evropës”. “[i] Për të marrë njohuri të specializuara për çështje të veçanta në lidhje me sundimin e ligjit në shtetet anëtare, Komisioni (Evropian)...si rregull i përgjithshëm dhe n; rastet kur është e përshtatshme, do t’i kërkojë këshilla Këshillit të Evropës dhe/ose Komisionit të tij të Venedikut”.⁷

22. Në nivel të Kombeve të Bashkuara, pas botimit të “Treguesve të sundimit të ligjit” në vitin 2011,⁸ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi në vitin 2012 Deklaratën e mbledhjes së nivelit të lartë të Asamblesë së Përgjithshme për sundim të ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ku pohohet se “Shteti i së drejtës vlen në mënyrë të barabartë për të gjitha shtetet si dhe për organizatat ndërkombëtare”.

6. Përfundimet e Këshillit për të drejtat themelore dhe sundimin e ligjit dhe për Raportin e vitit 2012 të Komisionit për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Mbledhja e Këshillit për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, Luksemburg, 6-7 qershor 2013, pjesa c, gjendet tek: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/jha/137404.pdf.

7. Kumesë e Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, ‘Një kornizë e re e BE-së për forcimin e sundimit të ligjit’, COM(2014) 158 final/2, http://ec.europa.eu/justice/effective-justice/files/com_2014_158_en.pdf.

8. Ky dokument është botim i përbashkët i Departamentit të Kombeve të Bashkuara për Operacione Paqeruajtëse (DOPR) dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR).

23. Agjenda e zhvillimit të qëndrueshëm, me 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) dhe 169 caqe që do të arrihen deri në vitin 2030, u miratua njëzëri nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në shtator të vitit 2015. OZHQ-të, të cilat përmbajnë caqe të shumta, synojnë të jenë vërtet transformuese dhe të kenë implikime të thella për realizimin e agjendës, duke parashikuar "[një botë] ku demokracia, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, si dhe kushte të favorshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, janë thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm..." Në kuadër të objektivës 16, shtetet zotohen që të "promovojnë shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të sigurojnë qasje në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtojnë institucione efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet". Shkalla e realizimit të Objektivës 16 do të vlerësohet kundrejt një numri caqesh, ca prej të cilëve përfshijnë komponentë të sundimit të ligjit si, për shembull, zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente (caku 16.6) dhe i vendimmarrjes së përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet (caku 16.7). Megjithatë, është Objektivë 16.3, sipas të cilit shtetet zotohen të "Promovojnë sundimin e ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të sigurojnë qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë", është ai që ofron mundësi unike për rigjallërimin e marrëdhënieve midis qytetarëve dhe shtetit. Kjo listë kontrolli mund të shërbejë si instrument tejet i vlefshëm për të ndihmuar në matjen cilësore të treguesve të sundimit të ligjit në kontekst të OZHQ-ve.

24. Kjo listë kontrolli synon të mbështetet në zhvillimet e përshkruara më sipër dhe të sigurojë një instrument për vlerësimin e sundimit të ligjit në një vend të caktuar nga pikëpamja e strukturave të tij kushtetuese dhe ligjore, legjisllacionit në fuqi dhe praktikës gjyqësore ekzistuese. Lista synon të mundësojë vlerësim objektiv, të plotë, transparent dhe të barabartë.

25. Lista e kontrollit orientohet kryesisht në vlerësimin e masave mbrojtëse ligjore. Megjithatë, zbatimi i duhur i ligjit është aspekt thelbësor i sundimit të ligjit që duhet të merret gjithashtu në konsideratë. Kjo është arsyeja pse lista e kontrollit përfshin disa kritere shtesë në lidhje me praktikën. Këto kritere nuk janë shteruese.

26. Për të analizuar nëse janë përmbushur parametrat nevojiten burime verifikimi (standarde). Për parametrat ligjorë, këto do të jenë ligjet në fuqi dhe, për shembull, në Evropë, vlerësimet e tyre ligjore nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Komisioni i Venedikut, organet monitoruese të Këshillit të Evropës dhe burime të tjera institucionale. Për parametrat që lidhen me praktikën, do të jetë e nevojshme të përdoren burime të shumta, përfshirë ato institucionale si CEPEJ dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore.

27. Lista e kontrollit është dedikuar si instrument në shërbim të një sërë akterëve që mund të vendosin të realizojnë vlerësime të këtij lloji. Këtu mund

të përfshihen parlamentet dhe autoritetet e tjera shtetërore që vlerësojnë nevojën dhe përmbajtjen e reformës legislative, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare, përfshirë ato rajonale, në veçanti Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian. Vlerësimet duhet të marrin parasysh tërë kontekstin dhe të shmangin çdo aplikim mekanik të elementëve të caktuar të listës së kontrollit.

28. Komisioni i Venedikut nuk është i mandatuar që me vetiniciativë të procedojë me vlerësime të sundimit të ligjit në vende të caktuara, megjithatë kuptohet që kur Komisioni duhet të trajtojë sipas kërkesës çështje të sundimit të ligjit në suazat e përgatitjes së ndonjë opinioni për ndonjë vend të caktuar, ai do ta bazojë analizën e tij në parametrat e listës së kontrollit brenda fushës së kompetencës së tij.

29. Sundimi i ligjit realizohet në hapa të njëpasnjëshëm që përmbushen në mënyrë progresive: sa më bazik të jetë niveli i sundimit të ligjit, aq më e madhe është kërkesa për të. Sundimi i plotë i ligjit është detyrë e vazhdueshme, madje edhe në demokracitë e konsoliduara. Në këtë kontekst, duhet të jetë e qartë se nuk është e nevojshme doemos që të plotësohen kumulativisht që të gjithë parametrat e listës së kontrollit në mënyrë që vlerësimi përfundimtar mbi pajtueshmërinë me sundimin e ligjit të jetë pozitiv. Vlerësimet duhet të marrin parasysh se cilët parametra nuk janë përmbushur, në çfarë mase, në çfarë kombinimi etj., dhe duhet të jetë objekt i shqyrtimit të vazhdueshëm.

30. Kjo listë kontrolli nuk është as shteruese dhe as përfundimtare: ajo synon t'i përfshijë elementët thelbësorë të sundimit të ligjit. Lista e kontrollit mund të ndryshojë me kalimin e kohës dhe të zgjerohet më tej për të mbuluar aspekte të tjera ose për të përfshirë hollësi të mëtejme, ashtu siç dhe mund të paraqiten problematika të reja që do të kërkojnë rishikimin e saj. Prandaj, Komisioni i Venedikut do të bëjë përditësimin e rregullt të listës së kontrollit.

31. Siç do të shpjegohet në kapitullin vijues, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Pa lejm të qasjes në të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit do të ishte vetëm një guaskë boshe dhe, anasjelltas, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut realizohet vetëm përmes respektimit të sundimit të ligjit: një regjim i fortë i sundimit të ligjit është jetik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Veç kësaj, sundimi i ligjit dhe disa të drejta të njeriut (si gjykimi i drejtë dhe liria e hprehjes) mbivendosen.⁹ Ndërsa është e qartë se sundimi i ligjit mund të realizohet plotësisht vetëm në një mjedis ku mbrohen të drejtat e njeriut, lista e kontrollit do t'i trajtojë shprehimisht të drejtat e njeriut vetëm kur ato janë të lidhura me aspekte të

9. Shih FRA (2014), *Një kornizë e brendshme strategjike e BE-së për të drejtat themelore: bashkimi i të drejtave themelore: bashkimi i forcave për të arritur rezultate më të mira*. Luxembourg, Publications Office of the European Union (Publications Office).

veçanta të sundimit të ligjit.¹⁰

32. Megjenëse Komisioni i Venedikut është organ i Këshillit të Evropës, lista e kontrollit vë në pah situatën ligjore në Evropë, siç pasqyrohet veçanërisht në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si edhe të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në suazat e kompetencave të saj të veçanta. Megjithatë, sundimi i ligjit është parim universal dhe ky dokument i referohet aty ku është e përshtatshme zhvillimeve në nivel global dhe në rajone të tjera të botës, veçanërisht në pjesën III e cila shqyrton standardet ndërkombëtare.

B. Sundimi i ligjit në mjedis të favorshëm

33. Sundimi i ligjit është i lidhur jo vetëm me të drejtat e njeriut, por edhe me demokracinë, pra me vlerën e tretë themelore të Këshillit të Evropës. Demokracia nënkupton përfshirjen e njerëzve në procesin e vendimmarrjes në një shoqëri, ndërsa të drejtat e njeriut mëtojnë t'i mbrojnë individët nga ndërhyrjet arbitrare dhe të tepruara në liritë e tyre dhe të garantojnë dinjitetin njerëzor. Sundimi i ligjit fokusohet në kufizimin dhe shqyrtimin e pavarur të ushtrimit të pushtetit publik. Sundimi i ligjit promovon demokracinë duke paraparë llogaridhënie për ata që ushtrojnë pushtetin publik dhe duke garantuar të drejtat e njeriut në mbrojtje të pakicave nga rregullat arbitrare të shumicës.

34. Sundimi i ligjit është shndërruar në “ideal dhe aspiratë globale”,¹¹ me një thelb të përbashkët të vlefshëm kudo. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se zbatimi i tij duhet të jetë i njëlojtë pavarësisht nga konteksti i posaçëm juridik, historik, politik, social apo gjeografik. Gjersa komponentët ose “përbërësit” kryesorë¹² të sundimit të ligjit janë konstantë, mënyra e veçantë e realizimit të tyre mund të ndryshojë nga njëri vend në tjetrin në varësi të kontekstit lokal, dhe në veçanti të rendit kushtetues dhe traditave të vendit në fjalë. Ky kontekst mund të përcaktojë edhe peshën relative të secilit prej komponentëve.

35. Historikisht, sundimi i ligjit u zhvillua si mjet për të kufizuar pushtetin e shtetit (të qeverisë). Të drejtat e njeriut shiheshin si mbrojtje nga ndërhyrjet e bartësve të këtij pushteti (“të drejtat negative”). Që atëherë perceptimet e drejtave të njeriut kanë ndryshuar në shumë shtete, si dhe në të drejtën evropiane dhe atë ndërkombëtare. Ndonëse me disa dallime në hollësi,

10. Për këtë çështje, shih në veçanti Raportin mbi sundimin e ligjit të miratuar nga Komisioni i Venedikut, CDL-AD(2011)003rev, § 59-61. Raporti nënvizon gjithashtu (§ 41) se “tani mund të ketë konsensus për elementët e nevojshëm të sundimit të ligjit si dhe ato të Rechtsstaat që nuk janë vetëm formale, por edhe substantive ose materiale” (të shtuar).

11. Rule of Law. A Guide for Politicians, HILL, Lund/The Hague, 2012, p. 6

12. Raport i Komisionit të Venedikut për Sundimin e Ligjit, CDL-AD(2011)003rev, § 37

ka një tendencë për ta zgjeruar shtrirjen e të drejtave civile dhe politike, veçanërisht në lidhje me njohjen e detyrimeve pozitive të shtetit për të garantuar mbrojtje efektive ligjore të të drejtave të njeriut në lidhje me akterët privatë. Kështu, termat përkatës janë “detyrimet pozitive për të mbrojtur”, “efektet horizontale të të drejtave themelore” ose “Drittwirkung der Grundrechte”.

36. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i ka njohur tashmë detyrimet pozitive në disa fusha, si për shembull në lidhje me nenin 8 të KEDNJ.¹³ Në disa vendime të saj, Gjykata ka përcaktuar detyrimet specifike pozitive të shtetit duke e ndërthurur nenin 8 të KEDNJ me parimin e sundimit të ligjit.¹⁴ Derisa në këto raste detyrimet pozitive për të mbrojtur nuk mund të burojnë vetëm nga sundimi i ligjit, parimi i sundimit të ligjit krijon detyrime shtesë për shtetin në kuptimin të garantimit të qasjes së individëve nën juridiksionin e tij në mjete juridike efektive për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tyre të njeriut, veçanërisht në situatat kur akterët privatë i shkelin ato. Pra, sundimi i ligjit siguron një pikë referimi për cilësinë e ligjeve që mbrojnë të drejtat e njeriut: dispozitat ligjore në këtë fushë, dhe përtej saj¹⁵, duhet të jenë, ndër të tjera, të qarta, të parashikueshme dhe jodiskriminuese, dhe duhet të zbatohen nga gjykata të pavarura, me garanci procedurale të barasvlershme me ato që zbatohen në konfliktet që rezultojnë nga ndërhyrjet e autoriteteve publike në të drejtat e njeriut.

37. Një nga elementët përkatës kontekstualë është sistemi juridik në tërësi. Burimet e së drejtës që përcaktojnë rregullat ligjore, duke garantuar kësioj sigurinë juridike, nuk janë të njëjta në të gjitha vendet: disa shtete i përmbahen kryesisht së drejtës së kodifikuar, me përjashtime të rralla, kurse tjerat mbështeten në respektimin e së drejtës precedente të bërë nga gjyqtari.

38. Shtetet mund të përdorin gjithashtu mjete dhe procedura të ndryshme, si për shembull në lidhje me parimin e gjykimit të drejtë, në procedurë penale (sistemi akuzator krahasuar me sistemin inkuizitor, e drejta për gjykim nga juria krahasuar me zgjidhjen e çështjeve penale nga gjyqtari). Mjetet materiale që janë të dobishme për garantimin e një gjykimi të drejtë, si ndihma juridike dhe lehtësira të tjera, mund të kenë po ashtu forma të ndryshme.

39. Ndarja e pushtetit shtetëror ndërmjet institucioneve të ndryshme shtetërore mund të ndikojë gjithashtu në kontekstin në të cilin konsiderohet kjo listë kontrolli. Ajo duhet të përshtatet mirë nëpërmjet një sistemi kontrollësh dhe balancash. Duhet të jetë e mundur që një gjyqësor i pavar-

13. Shih për shembull GJEDNJ, Centro Europe 7 dhe di Stefano kundër Italisë, 38433/09, 7 qershor 2012, § 134, 156; Bărbulescu kundër Rumanisë, 61496/08, 12 janar 2016, § 52ff.

14. Shih GJEDNJ, Sylvester kundër Austrisë, 36812/97 dhe 40104/98, 24 prill 2003, § 63; PP kundër Polonisë, 8677/03, 8 janar 2008, § 88.

15. Pasi garancitë e sundimit të ligjit vlejnë jo vetëm për të drejtat e njeriut, por për të gjitha ligjet.

ur dhe i paanshëm të rishikojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ushtrimit të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për ruajtjen dhe avancimin e sundimit të ligjit që sistemi gjyqësor të funksionojë mirë dhe që vendimet e tij të zbatohen në mënyrë efektive.

40. Në nivel ndërkombëtar, kërkesat dhe implikimet e sundimit të ligjit pasqyrojnë veçoritë e sistemit juridik ndërkombëtar. Në shumë aspekte ky sistem është shumë më pak i zhvilluar se sa sistemet kombëtare kushtetuese dhe ligjore. Përveç sistemeve të veçanta rajonale si ai i Bashkimit Evropian, sistemet ndërkombëtare nuk kanë ligjvënës të përhershëm dhe, në shumicën e rasteve, nuk kanë gjyqësor me kompetenca të detyrueshme, ndërkohë që karakteristikat demokratike në vendimmarrje janë ende tejet të dobëta.

41. Natyra mbikombëtare e Bashkimit Evropian e ka shtyrë atë të zhvillojë konceptin e sundimit të ligjit si parim i përgjithshëm i aplikueshëm për sistemin e tij juridik. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, sundimi i ligjit ngërthen epërsinë e ligjit, ekuilibrin institucional, shqyrtimin gjyqësor, të drejtat themelore (procedurale), përfshirë të drejtën në mjete juridike, si dhe parimet e barazisë dhe proporcionalitetit.

42. Elementet kontekstuale të sundimit të ligjit nuk kufizohen vetëm në faktorë juridikë. Prania (ose mungesa) e një kulture të përbashkët politike dhe juridike në një shoqëri, dhe raporti midis kësaj kulture dhe rendit juridik ndihmojnë për të përcaktuar se në çfarë mase dhe sa konkretisht elementët e ndryshëm të sundimit të ligjit duhet të jenë shprehimisht të cekur në ligjin e shkruar. Kështu, për shembull, traditat kombëtare në fushën e zgjidhjes së kontesteve dhe zgjidhjes së konflikteve do të kenë ndikim në garancitë konkrete të gjykimit të drejtë që sigurohen në një vend. Është me rëndësi që në çdo shtet kultura e fortë politike dhe juridike të mbështesë mekanizmat dhe procedurat e posaçme të sundimit të ligjit, të cilat duhet të kontrollohen, të përshtaten dhe përmirësohen vazhdimisht.

43. Sundimi i ligjit mund të lulëzojë vetëm në ato vende ku banorët ndihen kolektivisht përgjegjës për zbatimin e konceptit, duke e bërë atë pjesë integrale të kulturës së tyre juridike, politike dhe sociale.

II. Kriteret

A. Ligjshmëria¹⁶

1. Epërsia e ligjit

A njihet epërsia e ligjit?

- i. A ka Kushtetutë të shkruar?
- ii. A sigurohet përputhshmëria e legjislacionit me Kushtetutën?
- iii. A miratohen ligjet pa vonesë kur kjo kërkohet me Kushtetutë?
- iv. A përputhen veprimet e pushtetit ekzekutiv me Kushtetutën dhe ligjet e tjera?¹⁷
- v. A miratohen rregulloret pa vonesë kur kjo kërkohet me legjislacion?
- vi. A ka shqyrtim efektiv gjyqësor të përputhshmërisë së akteve dhe vendimeve të pushtetit ekzekutiv me ligje?
- vii. A realizohet ky shqyrtim gjyqësor edhe për aktet dhe vendimet e agjencive të pavarura dhe akterët privatë që kryejnë detyra publike?
- viii. A garantohet mbrojtje ligjore efektive e të drejtave individuale të njeriut përballë shkeljeve nga akterët privatë?

16. Parimi i ligjshmërisë njihet shprehimisht si aspekt i sundimit të ligjit nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, shih GJED, C-496/99 P, *Komisioni kundër CAS Succhi di Frutta*, 29 prill 2004, § 63.

17. Kjo rezulton nga parimi i ndarjes së pushteteve, i cili gjithashtu kufizon diskrecionin e ekzekutivit: krh. CM(2008)170, Këshilli i Evropës dhe Sundimi i Ligjit, § 46.

44. Veprimet e shtetit duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe të autorizuar me ligj. Derisa nevoja për shqyrtim gjyqësor të akteve dhe vendimeve të ekzekutivit dhe të organeve të tjera që ushtrojnë detyra publike është e njohur botërisht, praktikat kombëtare në kuptim të mënyrave të sigurimit të përputhshmërisë së legjislacionit me Kushtetutën janë tejet të larmishme. Ndërsa shqyrtimi gjyqësor është mjet efektiv për arritjen e këtij qëllimi, mund të ketë edhe mjete të tjera për garantimin e zbatimit të duhur të Kushtetutës për të garantuar respektim të sundimit të ligjit, siç është shqyrtimi *a priori* nga një komision i specializuar.¹⁸

2. Pajtueshmëria me ligjin¹⁹

A veprojnë autoritetet publike në bazë të ligjeve në fuqi dhe në përputhje me to?²⁰

- i. A janë të përcaktuara me ligj kompetencat e autoriteteve publike?²¹
- ii. A është e qartë ndarja e kompetencave ndërmjet autoriteteve të ndryshme?
- iii. A janë të përcaktuara me ligj procedurat që duhet t'i ndjekin autoritetet publike?
- iv. A mund të funksionojnë autoritetet publike pa bazë ligjore? A justifikohen rastet e tilla?
- v. A i respektojnë autoritetet publike detyrimet e tyre pozitive duke siguruar zbatimin dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut?
- vi. Në rastet kur detyrat publike u delegohen akterëve privatë, a parashihen me ligj garanci ekuivalente?²²

45. Kërkesë minimale e sundimit të ligjit është që kompetencat e autoriteteve publike të përcaktohen me ligj. Për aq sa ligjshmëria trajton veprimet e zyr-

18. Komisioni i Venedikut, në parim, është i favorshëm për shqyrtim të plotë të kushtetutshmërisë, por mjafton një zbatim i duhur i Kushtetutës: cf. CDL-AD(2008)010, Opinion mbi Kushtetutën e Finlandës, § 115 eff. Shih veçanërisht seksionin mbi Drejtësinë Kushtetuese (II.E.3).

19. Mbi hierarkinë e normave, shih CDL-JU(2013)020, Memorandum – Konferenca mbi standardet evropiane të sundimit të ligjit dhe fushëveprimi i diskrecionit të pushteteve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (Yerevan, Armeni, 3-5 korrik 2013).

20. Referenca për «ligjin» për aktet dhe vendimet që prekin të drejtat e njeriut gjendet në një sërë dispozitash të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë nenin 6.1, 7 dhe nenet 8.2, 9.2, 10.2 dhe 11.2 në lidhje me kufizimet e lirive themelore. Shih, midis shumë autoriteteve të tjera, GJEDNJ Amann kundër Zvicrës, 27798/95, 16 shkurt 2000, § 47ff; Slivenko kundër Letonisë, 48321/99, 9 tetor 2003, § 100; X. v. Letonisë, 27853/09, 26 nëntor 2013, § 58; Kurić dhe të tjerët kundër Sllovenisë, 26828/06, 12 mars 2014, §341.

21. Fuqia diskrecionale është, natyrisht, e lejueshme, por ajo duhet të kontrollohet. Shih më poshtë II.C.1:

22. Cf. më poshtë II.A.8.

tarëve publikë, ajo gjithashtu kërkon që ata të kenë autorizimin për të vepruar dhe që më pas të veprojnë brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë dhe, rrjedhimisht, të respektojnë të drejtën procedurale dhe materiale. Garancitë ekuivalente duhet të vendosen me ligj sa herë që pushtetet publike u delegohen akterëve privatë, veçanërisht në rastet e kompetencave shtrënguese, dhe jo vetëm. Për më tepër, autoritetet publike duhet t'i ruajnë aktivisht të drejtat themelore të individëve përballë akterëve të tjerë privatë.²³

46. Termi "ligj" mbulon jo vetëm kushtetutat, të drejtën ndërkombëtare, ligjet dhe rregulloret, por gjithashtu, aty ku është e përshtatshme, ligjet e krijuara nga vendimet e gjyqtarëve,²⁴ siç janë rregullat e sistemit anglosakson, ku që të gjitha janë të detyrueshme për kah natyra. Çdo ligj duhet të jetë i qasshëm dhe i parashikueshëm.²⁵

3. Marrëdhënia ndërmjet së drejtës ndërkombëtare dhe së drejtës vendore

A siguron sistemi juridik vendor që shteti të respektojë obligimet detyruese sipas së drejtës ndërkombëtare? Në veçanti:

- i. A siguron përputhshmëri me legjislacionin për të drejtat e njeriut, përfshirë vendimet detyruese të gjykatave ndërkombëtare?
- ii. A ka rregulla të qarta për zbatimin e këtyre detyrimeve në legjislacionin vendor?²⁶

23. Për referencë të kohëve të fundit të detyrimeve pozitive të shtetit për të garantuar të drejtat themelore të individëve përballë aktorëve privatë, shih GJEDNJ Bårbolescu kundër Rumanisë, 61496/08, 12 janar 2016, § 52ff (në lidhje me nenin 8 të KEDNJ).
24. Ligji "përfshin ligjin statutor si dhe praktikën gjyqësore", GJEDNJ Acour kundër Francës, 67335/01, 29 mars 2006, § 42; kf Kononov kundër Letonisë [GC], 36376/04, 17 maj 2010, § 185.
25. GJEDNJ The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr.1), 6538/74, 26 Prill 1979, § 46ff. Për kushtet e qasshmërisë dhe parashikueshmërisë, shih p.sh, GJEDNJ Kurić dhe të tjerët kundër Sllovenisë, 26828/06, 26 qershor 2012, § 341ff; Amann kundër Zvicrës, 27798/95, 16 shkurt 2000, § 50; Slivenko kundër Letonisë, 48321/99, 9 tetor 2003, § 100. Gjykata e Bashkimit Evropian konsideron se parimet e sigurisë juridike dhe pritshmërive legjitime nënkuptojnë se "efekti i legjislacionit të Komunitetit duhet të jetë i qartë dhe i pritshëm për ata që i nënshtrohen atij": GJED, 212 deri 217/80, Amministrazione delle finanze dello Stato v. SRL Meridionale Industria Salumi dhe të tjerë, 12 nëntor 1981, § 10; ose "që legjislacioni duhet të jetë i qartë dhe i saktë dhe zbatimi i tij të jetë i parashikueshëm për të gjitha palët e interesuara": GJED, C-585/13, Banka Tregtare Evropiane-Iraniane AG kundër Këshillit të Bashkimit Evropian, 5 mars 2015, § 93; shih GJED, C325/91, Franca kundër Komisionit, 16 qershor 1993, § 26. Për më shumë detaje, shih II.B (siguria juridike).
26. Cf. Neni 26 (pacta sunt servanda) dhe nenin 27 (ligjet vendore dhe respektimi i traktateve) të Konventës së Vjenës të vitit 1969 mbi të drejtën e traktateve; CDL-STD(1993)006, Marrëdhënia ndërmjet së drejtës ndërkombëtare dhe asaj vendore, § 3.6 (traktatet), 4.9 (zakonet ndërkombëtare), 5.5 (vendimet e organizatave ndërkombëtare), 6.4 (gjykimet dhe aktvendimet ndërkombëtare); CDL-AD(2014)036, Raport mbi Zbatimin e Traktateve të Drejtave të Njeriut në të Drejtën e Brendshme dhe Rolin e Gjykatave, § 50.

47. Parimi *pacta sunt servanda* (marrëveshjes duhet t'i përmbahemi) është mënyra në të cilën e drejta ndërkombëtare shpreh parimin e ligjshmërisë. Ai nuk trajton mënyrën në të cilën e drejta ndërkombëtare zakonore ose konvencionale zbatohet në rendin e brendshëm juridik, por një shtet "nuk mund t'i përdorë dispozitat e së drejtës vendore si justifikim për mospërbushje të marrëveshjes/traktatit"²⁷ ose mosrespektim të së drejtës zakonore ndërkombëtare.

48. Parimi i sundimit të ligjit nuk imponon zgjedhje midis monizmit dhe dualizmit, por *pacta sunt servanda* zbatohet pavarësisht qasjes kombëtare ndaj marrëdhënieve ndërmjet së drejtës ndërkombëtare dhe asaj vendore. Sidoqoftë, zbatimi i plotë i brendshëm i së drejtës ndërkombëtare është thelbësor. Kur e drejta ndërkombëtare është pjesë e së drejtës vendore, ajo bëhet ligj i detyrueshëm në kuptim të paragrafit paraprak lidhur me epërsinë e ligjit (II.A.2). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ajo duhet të ketë gjithmonë epërsi ndaj Kushtetutës apo legjislacionit të zakonshëm.

4. Kompetencat ligjbërëse të ekzekutivit

A sigurohet epërsia e legjislativit?

- i. A përfshihen rregulla të përgjithshme dhe abstrakte në një akt parlamenti ose rregullore të bazuar në atë ligj, përveç përjashtimeve të kufizuara të parapara në Kushtetutë?
- ii. Cilat janë ato përjashtime? A janë të kufizuara në kohë? A kontrollohen nga Parlamenti dhe gjyqësori? A ka mjet efektiv kundër abuzimit?
